

**INFORMACION PER PUBLIKIM NE WEB**

**PROCEDURA E KONSULTIMIT PER LEJE MJEDISORE  
TIPI B**

**“Univers Reklama” sh.p.k.”**

**AKTIVITETI: “Prodhim dhe montim reklamash te te  
gjitha llojeve”**

**VENDODHJA: Kashar, Godina 3 kateshe, mbi-kalimi i  
Rinasit, Tirane**

**1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”;**

Ky aktivitet, klasifikohet per Leje Mjedisore Tipi B, bazuar ne Ligjin Nr. 10 448, date: 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”, te ndryshuar, Shtojca I, Veprimtaritë e mbulimit të sipërfaqes dhe të stampimit, ID. 7.9 – Pika E, ku kapaciteti I perdorur eshte per leje tipi B.

**2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;**

K41926003N, Shoqeria “Univers Reklama” sh.p.k.

**3. Adresën e vendodhjes së instalimit:**

Kashar, Godina 3 kateshe, mbi-kalimi i Rinasit, Tirane

**4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;**

“Prodhim dhe montim reklamash te te gjitha llojeve”

**5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;**

Ky aktivitet, klasifikohet per Leje Mjedisore Tipi B, bazuar ne Ligjin Nr. 10 448, date: 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”, te ndryshuar, Shtojca I, Shtojca I, Veprimtaritë e mbulimit të sipërfaqes dhe të stampimit, ID. 7.9 – Pika E, ku kapaciteti I perdorur eshte per leje tipi B.

K41926003N, Shoqeria “Univers Reklama” sh.p.k. Kashar, Godina 3 kateshe, mbi-kalimi i Rinasit, Tirane

“Prodhim dhe montim reklamash te te gjitha llojeve”

## **6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar**

Te pergjithshme

Objekti është ekzistues. Shoqëria “Univers Reklama” sh.p.k. me NIPT K41926003N, në adresën: Kashar, Godina 3 kateshe, mbi-kalimi I Rinasit, Tirane, është pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, me PN-7442-06-2014, për aktivitetin “Prodhim dhe montim reklamash të të gjitha llojeve”.

Në linjen tone, duke qenë se përdoret edhe boja, pas ndryshimeve ligjore, ky aktivitet, klasifikohet për Leje Mjedisore Tipi B, bazuar në Ligjin Nr. 10 448, datë: 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca I, Veprimtaritë e mbulimit të sipërfaqes dhe të stampimit, ID. 7.9 – Pika E, ku kapaciteti I përdorur është për leje tipi B.

Sa më sipër, duhet t’i nënshtrohemi procedurës së aplikimit për Leje Mjedisore Tipi B, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore

Gjeneza e Univers Reklama nisi në 17 Janar 2001, pas evolucionit të grimcave të industrisë universale të reklamave dhe vizionit afatgjatë të themeluesit, Mirel Salija.

Investimi fillestar i kompanisë ishte afërsisht 20 milion lireta, sot vlera e investimeve llogaritet në disa milion euro, në një treg tashmë të masivizuar, me subjekte të shumtë duke thënë me bindje se Univers Reklama ka qenë iniciatori dhe institucionalizimi real i tregut të reklamave indoor dhe outdoor në Shqipëri, për ndërmarrje dhe individë.

Univers Reklama zotëron kapacitete të mjaftueshme teknologjike dhe njerëzore për të ndërmarrë punime dhe projekte të madhësive të ndryshme, duke siguruar ekspertizë në ideim, dizejn, realizim, montim dhe mirëmbajtje me një cilësi të padiskutueshme.

Univers Reklama që nga themelimi mban pozicionin lider në Shqipëri dhe prej vitit 2013 ka shtrirë veprimtarinë e saj edhe në rajon duke ofruar produkte dhe shërbime për shumë klientë nga vendet fqinje. Për projekte të veçanta është punuar edhe për klientët nga shtete të tjera europiane, si Gjermania apo Franca.

Makineritë më të avancuara të prodhimit dhe përpunimit të materialeve sjellin automatizimin në nivel të lartë të proceseve tona.

### Teknologjia e Printimit

Ploterat janë të profilizuar për printime indoor dhe outdoor në shpejtësi dhe cilësi të lartë, të cilët arrijnë të printojnë materiale me gjerësi deri në 5m dhe me bojëra UV të materialeve si: Selfadeziv, mash, banner, letër, tekstil, film etj. Printimet realizohen me bojëra 100% ekologjike (6 ngjyra) në cilësi të padiskutueshme prej 1200x1200dpi me jetgjatësi deri në 3 vjet pa plastifikim dhe 5 vjet me plastifikim. Ploterat e profilizuar për printime direkte në materiale të ngurta, si etlabond, pleksiglass, foreks, MDF, mermer, pasqyrë, etj. Teknologjia Latex e printimit. Univers Reklama, e vetmja në tregun shqiptar e cila diferencon për përdorimin e saj në printimet dixhitale. Krahasuar me bojën solvent, të cilën përdor masivisht industria e printimeve, bojërat Latex janë tërësisht ekologjike, duke i bërë produktet miqësore me ambjentin e brendshëm dhe të jashtëm.” Univers Reklama ekzekuton printimin e letrës murale 100% në ploterat e avancuar HP të cilët operojnë me bojërat dhe teknologjinë Latex. Teknologjia e printimit e përdorur nga Univers Reklama është e dizenuar për të qenë ambjentaliste dhe për të ruajtur shëndetin tuaj. Teknologjia e vecante e dedikuar vetem për printimin e tekstilit.

Freza për prerje të materialeve si: pleks, etlabond, foreks, karton, MDF, etj. Me gjerësi deri në 2.21m gjatësi deri në 3.2 m, dhe trashësi 2.5 cm. Lazeri i prerjes së metaleve si alumin, inoks, bronz, në trashësi deri 8 cm në mënyrë të automatizuar. Makineri të termoformimit me vakuum dhe kuposje mekanike. Makineri të lyerjes kromatike, saldimit dixhital, Furrë + Presë.

**a) një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit**

Vegjetacioni që takohet në këto zone kodrinore dhe fushore është tipik i mjediseve të ulta e kodrinore, anash rrjedhjeve ujore-kanaleve kullues të tokave bujqësore. Karakteristika e parë e tij është plasticiteti i lartë ekologjik i

shoqerimeve qe pasqyrohet qarte ne perberjen floristike te tij. Ne brigjet e lumit Tirana qe ndodhet

larg zones me rreth 1.3km dhe tributareve llojet shoqeruese me vlera te larta te sasi-mbuleses perfaqesohen nga: Typha latifolia, Lythrum salicaria, Cladium mariscus, alisma plantago-aquatica, Sparganum erectum etj.

Flora e habitatit te marre ne konsiderate (Toka te punuara) eshte e varfer ne lloje dhe monotone. Hapesira paraqitet e ekspozuar ndaj rezatimit te diellit. Numri i llojeve ketu eshte i ulet dhe ato jane direkt te kercenuara nga veprimtaria e njeriut. Duhet te nenvizojme faktin se perdorimi i pesticideve dhe herbicideve per nje kohe te konsiderueshme ka afektuar ndjeshem larmine biologjike te territorit te mare ne konsiderate.

Nga familjet me te takueshme, me nje numer me te madh bimesh jane: Compositae, Graminae, Leguminosae, Cruciferae, Papaveraceae, Poligonaceae, Convolvulaceae dhe Primulaceae.

Lloji me i dendur ne mbi 40% te nje rilevimi shume te shpejte eshte Papaver rhoeas dhe me pas permendim llojet: Avena sterilis, Lactica seriola, Alopecurus myosuroides, Sinapis arvensis, Capsella bursa-pastoris, Sonchus vulgaris, Anagalis arvensis, Madicago lupulina etj.

**b) informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj**

- a. Ne kete rajon takohen ujerat nentokesor ne depozitat zhavorr. Niveli i ujit nentokesor eshte 3.80m nga siperfaqja e tokes por ne puset e shpimit ai arrin te ngrihet dhe te stabilizohet ne 0.6-0.8 m thellesi dhe ne varesi te stines niveli i tyre ndryshon. Pasqyra e nivelit te perhershem te ujerave nentokesor luhaten sipas rreshjeve.
- b. Ne zonen ku do te realizohet projekti verehet se nuk ka burime siperfaqesore ne distanca te aferta. Ne zonen e shfrytezimit dhe perreth saj nuk ka zona te lundrueshme dhe nuk ndodhen liqene dhe dete, prandaj gjate shfrytezimit nuk do te cenohen rruget ujore, brigjet bregdetare etj. Ne konturin anesor te zones dhe ne pjesen lindore te prones ne studim vihet re ish kanalet e drenazhimit qe kane ekzistuar per keto toka are dhe truall.

**c. Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;**

**1-Ndikimet ne popullsi**

Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti eshte relativisht larg qendrave te banuara rreth 5 00m dhe nuk sjell shqetesime per ta vecse rrit mundesine e punesimit. Nga ngritja e aktivitetit nuk do te kemi shpronesime dhe zhvendosje te popullsisë. Ky aktivitet do te sjell te mira e sherbime jo vetem per investitorin por edhe per komunitetin.

**2-Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

**3-Ndikimet ne biodiversitet**

Objekti ndodhet ne toke truall, e cila nuk shquhet per pasuri te vecante te botes bimore e shtazore. Nga ky aktivitet nuk do te vijne shqetesime si humbje te bimesise, prishje habitatesh, ekosistemesh etj.

**4-Ndikimet ne uje**

Duke qene se objekti ndodhet larg burimeve ujore siperfaqesore si lum, perrua, liqen etj, nuk kemi ndikime ne uje. Po keshtu edhe per burimet nentokesore ky aktivitet nuk perben rrezik, pasi ujerat nuk do te derdhen per asnje arsye te patrajtuar dhe pa kriter ne mjedisin perreth.

**5-Ndikimet ne toke**

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi humbje te tokes, rreshkitje te dherave, erosion etj. Asnje lloj mbetjeje nuk do shkarkohet ne toke pa u trajtuar me pare dhe pa kriter.

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk gjenerohen mbetje te ngurta te cilat te perbejne rrezik per ndotjen e tokes, jashteqitjet e kafsheve ne kompleks do te shkojne per perdorim te pleherimit te tokes nga ana e fermereve. Mbetjet qe gjenerohen

nga aktiviteti i pergjithshem i personelit apo ato te tipit ambalazh, shkon ne vendet e caktuara nga pushteti lokal.

## **6-Ndikimet ne ajer**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk do te kemi emetime te gazeve te demshem apo te ererave te renda ne mjedisin perreth, pasi nuk kemi te bejme me linje prodhimi ku kemi produkt perfundimtar.

### **d. Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;**

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit te mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteteve te ndryshme te cilat mund te kene ndikim ne mjedis.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimet e mbrojtjes se mjedisit
- Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore
- Parimi i zevendesimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes se integruar
- Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunimit
- Parimi "Ndotsi paguan"
- Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
- Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te perberesve te mjedisit nga ndotja, si vegmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

- Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:
- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujerave
- Mbrojtja e tokes
- Mbrojtja e natyres
- Ndryshimet klimatike

Instalimi dhe funksionimi i aktivitetit, gjeneron mbetje sidomos gjate fazes se funksionimit. Investitori ne bashkepunim me expertin e mjedisit, do te marre masa per menaxhimin e mbetjeve qe do te gjenerohen, duke minimizuar gati ne eliminim efektet negative ne mjedis. Per kete do te investohet duke blere paisje bashkekohore qe do t'i vijne ne ndihme planit te menaxhimit te mbetjeve. Ato do te montohen ne kompleks gjate fazes ndertimore.

Sasia me e madhe e ndotjeve per kete aktivitet, gjenerohet gjate fazes se funksionimit

### **Mbetjet e ngurta**

Gjate zhvillimit te aktivitetit do te gjenerohen mbetje te ngurta te cilat nuk perbejne rrezik per ndotjen e tokes. Keto mbetje vijne nga aktiviteti i ndertimit qe klasifikohen si mbetje inerte. Mbetjet inerte do te menaxhohen ne bashkepunim me perfaqesues te Njesise se Qeverisjes Vendore, bazuar edhe ne VKM Nr. 575, date 24.06.2015, "Per menaxhimin e mbetjeve inerte". Keto mbetje do te depozitohen ne nje zone te caktuar nga Bashkia. Nje pjese e ketyre mbetjeve do te sistemohen ne sheshin e ndertimit pas perfundimit te punimeve. Do te perdoret per mbushje te aneve te themeleve, per sistemimin e sheshit dhe siperfaqet e gjelberta.

#### **e. Informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;**

Ndikimet ne fazen e instalimit, parashikohen te zgjasin vetem dy muaj, kohe kjo qe duhet per ngritjen e objektit.

Per fazen e instalimit, nga ana e investitorit do te behet e mundur qe kohezgjatja te jete sa me e shkurter qe te jete e mundur. Pra me masat e parashikuara me siper, mendohet qe ndikimet ne mjedis te jene gati zero ne shtrirjen ne kohe. Si u theksua ashje s' do te shkarkohet ne toke, uje apo ajer.

#### **f. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;**

Bazuar në karakteristikat dhe elementet e projektit, distanca e ndikimit në mjedis mund të shtrihet vetëm në një zonë periferike të kufizuar dhe ku nuk



mund te ndikohen ne objekte banime ose te tjera. Për aktivitetet e ndërtimit distance nga ku mund të përceptohet vibrimi është si vijon:

- Punimet germuese të tokës deri 10 -15 m largësi.
- Kompaktesimi dhe ngjeshja me vibrim 10 – 15 m largësi.
- Levizja e kamioneve të rëndë, 5 deri 10 m.

Duke pasë parasysh keto distanca e vendodhjen e objektit, nuk ka objekte që të jenë të ndikuara nga vibrimi.

**g. Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshmedhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;**

Rehabilitimi mjedisit të ndikuar është akti i restaurimit të mjedisit për ta kthyer atë në gjendjen origjinale, para ndikimeve ne këtë rast nga zbatimi i projektit. Nëpërmet rehabilitimit synohet mbrojtja e cilësivë natyrore të trasheguara të mjedisit, mbrojtja e shendetit të punonjësve, mbrotja e cilësisë së ujrave nëntoksore e sipërfaqësore, mbrojtja së cilësisë së tokës, ajrit, garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm ne harmoni me mjedisin. Kthimi i mjedisit në gjendje të mëparshme është një proces që përfshin zbatim masash e veprimesh që bëjnë përgatitjen e sistemimin e terrenit të ndikuar, për parandalimin e erozionit, të ngjeshjes se metejshme te tokes, për gjelbërimin e rigjelbërimin, si dhe çdo ndërhyrje tjeter në mënyrë të vazhdueshme që garanton shendetin e mjedisit. Masat rehabilituese të përcaktuara në planin të rehabilitimit zbatohen duke kryer punime që adresojnë kërkesat teknike si dhe ato estetike e ekologjike. Sistemimi i sheshi të ndertimit të objektit është ngushtësisht i varur nga kërkesat teknike inxhenerike të ketij objekti, distancat e sigurisë, efektiviteti i perdorimit racional të tokës në vartësi të parametrave teknik të projektit. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngushte me respektimin e kushteve teknike inxhinierike të projektit. Shtresezimet e sipërfaqesore te sheshit midis elementeve te ndertimor të objektit, koridoret qarkulluese e te sherbimeve te mirembajtjes duhet të respektojnë rigorozisht kushtet teknike. Zona periferike jashtë sheshit është sipërfaqe me aktivitet bujqësor, si dhe rruga hyrese duhet të restaurohet në rastin e ndikimeve të paevitueshme. Po kështu duhet të veprohet me të gjithë elementet jashtë objektit që mund të jenë ndikuar. Parashikimi i gjelberimit ne objekt nga projekti, si dhe rishikimi i gjelberimit për shtimit e tij në të gjitha anët e objektit duhet të bëhet për të plotësim sa më

maksimalisht kërkesat përmirsuese e restauruse estetike dhe ekologjike por dhe për zbutjen e ndikimit nga zhurmat e stallës dhe aromave të pakëndeshme. Llojet bimor që përdoren për rritjen e vlerave estetike mjedisore rurale janë në vartesi të volumit të kurores vegetative të llojit, anës dekorative që prezanton si dhe dendesise së përdorimit të llojit. Nga vezhgimi i llojeve të zonës, mund të aplikohet mbjellja e plepit, shelgut, frasherit, por dhe e bimeve perhere te gjelberta si tuja, ilqja, dafina etj.

Sistemimi i terrenit të ndikuar dhe përgatitja e vendit.

Nderhyrja e parë që behet për rehabilitimin e vendit është sistemimi i tij, dhe sigurimi e ruajtja e vendit nga mosdemptimi, gjatë punimeve rehabilituese.

Masat e sugjeruara

Punimet e pastrimit e sistemimit të vendit pas përfundimit të ndertimit të objektit ndertimor përfshijnë:

- Largimi i të gjitha pajisjeve e mjeteve që kanë shërbyer gjatë procesit ndertimor e instalimeve në objekt.
- Largimi dhe administrimi i përshtatshëm i të gjitha mbetjeve inerte nga teritori që rehabilitohet dhe çdo lloje mbetje tjetër në qofte se nuk është trajtuar apo neglizhuar.
- Marrja e masave në pengimin e qarkullimit të lirë të njerezve e kafshëve deri në rahabilitimin e plotë të zonës.

Përdorimi i bimësisë si pjesë e projektit është ndikimi më potencial në krijimin e një ekulibri të stabilizuar rural e bujqësor me funksion të shumfishtë ripërtritës e me ndikime direkte në përmirsimin e treguesve mjedisor. Ndikim të rëndësishem ka në përmirsimin e vlerave pejsazhiste, duke përmirsuar aspektin pamor dhe duke ndikuar njëkohesisht në zbutjen e ndikimeve të tjera.

Masat e sugjeruara

- Përdorimi i bimeve gjithnje të gjelberta e që të përshtatet me kerkesat estetike, ekologjike e mjedisore në tëresi dhe që garanton suksesin e përmirsimit të pejsazhit rural.
- Përdorimi i nje shtrese me matërial të tillë që të ndaloje mbirjen e barerave të këqija rreth fidaneve, ruajtjen e për ruajtjen e lageshtirës.

Mbjellja e fidaneve

Mbjellja behet me anë të fidaneve të prodhuar ne fidanishte të llojeve autokton e ato që përshtaten kushteve të tokes e klimës. Skemat e mbjelljes të llojeve behen duke respektuar dendesinë e lejuar si dhe kombinimet e llojeve.

## Mirëmbajtja

Punimet për mirëmbajtjen lidhen me shërbimet që kërkojnë rritja e bimesisë për plotësimin e kërkesave për ujë, element ushqyes, krasitje, pastrim etj. Në mënyrë të veçantë do të bëhet menjëherë zëvendësimi i fidaneve që rezultojnë të dështuara në mbirje ose që zhvillohen të dobët në krahasim me pjesën tjetër.

## Monitorimi

Monitorimi lidhet me të gjithë aspektet e mbarvajtjes së nderhyrjeve rehabilituese për të garantuar suksesin e saj. Inspektimet e vazhdueshme në lidhje me zenien e fidaneve e të gjendjes së vegetacionin në tëresi do të shërbejnë për marrjen e masave të menjëhershme të vijshmërisë së sukseseshme të rehabilitimit.

Masat kryesore për zbutjen e ndikimeve negative në të gjitha fazat e zbatimit të projektit si dhe të funksionimit, janë të paraqitura në tabelën në vijim ku janë patrashtruar edhe kostot e përafërta financiare. Masat e identifikuar ju referohen praktikave më të mira rehabilituese si pjesë e planit të menaxhimit mjedisor në tëresi ku kostot e vlerësuara përfshihen në kostot e zbatimit të projektit.

Vepërtaria	Efektet potenciale	Plani i minimizimit e zbutjes së ndikimit	Përgjegësia	Kosto e përafërt në \$
Pastrimi e përgatitja e vendit ku zbatohet projekti	Ngjeshje e dendësisë së strukturës së tokës së zonës në afërsi	Rrethimi i sheshit të ndërtimit. Ndalimi i nderhyrjeve të panevojshme në afërsi. Krijimi i sektorit të punimeve brenda sheshit dhe spostimet e nevojshme sipas kërkesave teknike e zhvillimore të objektit. Vendosja e tabelave sinjalizuese	Zhvilluesi	100 (pa elementet e sektorit)
Sistemimi i vendit të punës	Presioni në sistemin drenazhues dhe erozionin e tokës	Berja e zbatimit i një plani drenazhimi për mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe evitimi i pellgjeve me ujë.	Zhvilluesi	800
Hapjet e themeleve	Emetime ndotëse në ajër	Levizja e evadimit e dherave të behen në kushtet e lagës për uljen e pluhurës. Sperkatja e herepas-hershme e stoqeve, mbajtja e mjedisit pastruar.	Zhvilluesi	600
Punimet e ndërtimit	Ndikimi me zhurmat e vibrimet	Pajisjet e ndërtimit duhet të jenë sipas Direktivave Standardeve të Komunitetit Europian 2000/14/EC, Maj. 2000. Kjo direktivë aplikohet tek prodhuesit e pajisjeve që gjenerojnë zhurmë. Të gjitha pajisjet duhet të mbahen në kushte të mira.	Zhvilluesi	Të vogla
Largimi i mbetjeve nga pastrimi i terrenit	Ndotja e ajrit, Ndikim në ndotjen e tokës	Perdorimi i mbetjeve nga pastrimi i hapjeve të themeleve, për mbushje. Sigurimi i paisjeve personale	Zhvilluesi	800

	Ndikimi ne shendetin e punonjesve	mbrojtese nga pluhurat. Evitimi i shpejtesive te panevojshme te automjeteve		
Punimet operatore ne objekt	Mungesa e vegjetacionit	Rishikimi i projektit per gjelberimin ne të gjitha anët të objektit. Mirembajtja.	Studio projektuese Zhvilluesi	2500
Punime operatore	Rreziku i demtimit te infrastruktures.	Mirëmbajtja e riparimi i menjehershme sipas rastit.	Zhvilluesi	600 (gjate ndert).
Prodhimi i mbetjeve te rrezikshme si dhe ujrave te zeza gjate operimit e funksionimit	Ndotja e tokes, e ujrave siperfaqesore e nentoksore	Hartimi i planit të menaxhimit të mbetjeve. Sigurimi i marrveshjeve per perdorimin e plehut te stalles e ujrave te perdorura. Marrveshjet e kontratat me subjektet sipas rastit.  Perdorimi i gropes septike per ujrat e zeza e evadimi i pershtatshem.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvilluesi</li> <li>• Fermeret</li> <li>• Subjektet qe kryejne sberbime</li> </ul>	1500 (nga zhvilluesi gjate ndertimit e funksionit)

#### **h. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;**

##### **-Kushtet e punes**

Investitori do te krijojë kushte te favorshme pune per punonjesit e tij. Per te permbushur sigurine e punetoreve ofron kushte te mira pune, ambient te bollshem dhe duke perdorur lende te kontrolluara dhe pa efekte anesore. Punetoret jane te pajisur me uniforma dhe maska gjate proceseve te punes, zbatohet me rigorozitet rregullorja e higjenes se vendit te punes. Stafi eshte me eksperience ne kete fushe. Jane marre masa per sigurimin teknik ne kantierin e ndertimit.

##### **-Mbrojtja nga zjarri**

Ne zbatimin e germes b, te nenit 34, te Ligjit Nr.8766 date 05.04.2001 "Per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin", do te merren masat e nevojshme per mbrojtjen ne raste rreziku apo renie zjarri. Per nje siguri maksimale ne ambientet e punes nga drejtuesit e saj, do te merren te gjitha masat per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes nga zjarri.

Brenda objektit do te vendosen ne vende te dukshme paisje te mbrojtjes nga zjarri, si dhe do te merren masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

Per mbrojtjen nga Zjarri do te merren masat e meposhtme:

Do te kete fikese zjarri me kapacitet 50 kg (pluhur fosil dhe gaz karbonik).

Do te kete nje depozite uji

Do te kete rregullore te brendshme per mbrojtjen ndaj zjarrit.

Personeli do teinstruktohet me rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit.

Hyrja per ne objekt do te kete hapesire te konsiderueshme per automjetet e zjarrfikseve.

**-Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te cojne perfundimisht ne perftimin e pamjeve te parashikuara ne projekt, me siperfaqe te pastra, te sistemuara e te gjelberuara.

**7. Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;**

Projekti do te zhvillohet brenda kufijve te Republikes se Shqiperise dhe nuk ndodhet prane kufije, pra perjashtohet fakti qe te kete ndikime ne mjedisin nderkufitar.

**8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;**

AKM merr ne shqyrtim dhe jep vendim, sipas afateve ligjore ne fuqi